

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Trupi i 39-vjeçarit gjendet i copëtuar në Torino, festa me drogë përfundon në krim makabër! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/trupi-i-39-vjecarit-gjendet-i-copetuar-ne-torino-festa-m-e-droge-perfundon-ne-krim-makaber/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 08:41:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 08:38:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	69cc5291786be8c8c046a394d0a22ca308a6f1e64961e600c6af3f31b45b64cf
TEKSTI	bad1638227873f6143b867bb92a219a2a03d4beb3fe00e50cd189a18b90c22a7
PAMJA	c5aad9e41198a05bc6b20daf35d9edd1133c4df8a03123e19266a5af118cfd26

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	013eb48697c1c1c976e1309dede4d23393ffdc93ca55947d1b3f34629632ffdc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b28949f398f9c40f36f567d35f036ed2a879d9ccf77f144b0ee032f95e15789d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/013eb48697c1c1c976e1309dede4d23393ffdc93ca55947d1b3f34629632ffdc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Bota

Trupi i 39-vjeçarit gjendet i copëtuar në Torino, festa me drogë përfundon në krim makabër!



Marisa Karabeci

28 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Detaje të reja janë zbardhur nga hetimet për vdekjen e 39-vjeçarit Fabio Colapietro, trupi i të cilit u gjet i copëtuar brenda një apartamenti në periferi të Torinos. Për ngjarjen është ndaluar Christian Matheus De Oliveira Morando, 26 vjeç, i cili ka pranuar para autoriteteve se ka shkakuar vdekjen e viktimës, por ka mohuar se bëhej fjalë për një krim të planifikuar. Sipas versionit të dhënë nga i riu gjatë marrjes në pyetje, përplasja me Colapietron dyshohet se nisi për një shumë prej rreth 50 eurosh. Ngjarja kishte ardhur pas disa ditësh gjatë të cilave në apartament ishte zhvilluar një festë, e shoqëruar, sipas hetimeve, me konsum të alkoolit dhe substancave narkotike.

Mbrojtja e 26-vjeçarit ka deklaruar se klienti i saj ndodhet në gjendje konfuzioni dhe ka ngritur dyshime se ai mund të mos ketë vepruar i vetëm. Avokati ka përmendur përdorimin gjatë atyre ditëve të disa llojeve të substancave, mes tyre crack, LSD, kanabis, kërpudha halucinogjene dhe MDPHP, si dhe sasi të konsiderueshme alkooli. Sipas rrëfimit të të dyshuarit, pasi ishte zgjuar një ditë më pas, i ishte thënë se Colapietro mund t'i kishte marrë rreth 50 euro. Mes tyre më pas kishte shpërthyer një konflikt fizik. Mbrojtja pretendon se gjatë përleshjes 39-vjeçari është rrëzuar dhe ka humbur jetën.

"E vrava, por pa dashje. Sigurisht që nuk ishte e planifikuar", mësohet të ketë deklaruar 26-vjeçari përpara gjyqtarit. I pyetur nëse e kishte kapur Colapietron nga qafa gjatë konfliktit, i dyshuari ka deklaruar se nuk e mbante mend. Avokati i tij pretendon gjithashtu se pas ngjarjes janë bërë përpjekje për rreth dy orë për ta rikthyer 39-vjeçarin në jetë, përmes frymëmarrjes artificiale dhe masazhit kardiak. Hetuesit po përpiqen ndërkohë të përcaktojnë rolin e personave të tjerë që ndodheshin në apartament. Në kuadër të çështjes janë marrë në pyetje edhe Nicole Formichetti, 47 vjeçe, e cila kishte marrë me qira banesën, si dhe 22-vjeçarja Keith Butig. Ato dyshohen për veprime që lidhen me fshehjen e trupit dhe favorizimin.

Formichetti nuk ka dhënë përgjigje gjatë seancës para gjyqtarit. Mbrojtja e saj ka argumentuar se ajo nuk ishte në gjendje të dëshmonte dhe se mund të merret në pyetje në një fazë të mëvonshme. Butig ka mohuar çdo përfshirje në vrasjen e 39-vjeçarit. Sipas avokatit të saj, ajo kishte qenë e pranishme gjatë festës dhe kishte blerë disa qese të zeza, por nuk kishte marrë pjesë në veprimet e mëvonshme. Mbrojtja pretendon se 22-vjeçarja ndodhej në gjendje të rënduar dhe ishte izoluar në një prej dhomave të apartamentit. Autoritetet italiane po vijojnë hetimet për të rindërtuar dinamikën e plotë të ngjarjes dhe për të përcaktuar përgjegjësinë e secilit person të përfshirë. Ndërkohë, pritet edhe vendimi i gjyqtarit lidhur me masat ndaj personave të ndaluar.

LAJME TË NGJASHME



Rihapet hetimi për vrasjen e gazetares së BBC-së në vitin 1999/Autori dyshohet se është kriminel serb...

1 MIN



24-vjeçari dënohet me vdekje...për një koment në Facebook!

1.5 MIN



Skenar lufte! Lituania teston evakuimin e Vilniusit në rast sulmi, stërvitja më e madhe ushtarake përfshin mijëra zyrtarë

2.5 MIN



Orteku godet ekspeditën në Himalaje, 10 alpinistë rezultojnë të zhdukur

1.5 MIN



Rusia sulmon Ukrainën, Zelensky: Moska s'është e gatshme t'i japë fund luftës

3.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Andy Carroll rikthehet në fushën e futbollit pas rrëfimit për sulmin seksual!



"Patëm një dasmë të madhe shqiptare..."/ Dua Lipa ndan pamje nga dasma familjare!



"Para nga qielli"/Parashikimi i Baba Vanga-s për dy shenjat e zodiakut!



Nations League, sonte SHQIPERI vs. BJELLORUSI/Ekskluzivisht në DigitAlb!



Aksident në Fushë-Krujë/Përplasen 3 automjete, humb jetën një 19-vjeçar!



Duni e natëndrueshme dhe



Gjiganti italian i modës Gucci
nxjerr në treg atlete "Made in
China"!



Tanimë gjërat kanë
ndryshuar/Shenjat e zodiakut që
më në fund po fillojnë një
kapitull të ri të jetës së tyre!



A kaloni shumë kohë ulur? Ja
çfarë mund të ndodhë nëse ecni
çdo gjysmë ore!



A ju ndodh të shihni të njëjtën
ëndërr vazhdimisht? Çfarë mund
të fshihet pas saj?

EDITORI SUGJERON



Apple surprizon me risitë, AI bën
gabimin e frikshëm dhe Tesla
rikthen makinën që "fluturon"!



As viti i shtatë dhe as i dhjetë, ja
se kur tradhtojnë çiftet në një
lidhje...



Pas 8 vitesh pritjeje, Tesla
Roadster rikthehet me një
premtim të çmendur: Makina që
mund të fluturojë?!



Një identifikim i gabuar nga AI
ngriti në këmbë ushtrinë e
SHBA-së, gati për sulm! Ja si
ndodhi gjithçka...



Apple Watch tani "dëgjon"
bisedat tuaja dhe i përmbledh për
ju?! Risia që po ngre
pikëpyetje...



Keni rënë në dashuri?! Apo është
thjesht...



Apple më në fund palos iPhone-
in dhe vjen me "iPhone Duo"...
por a ia vlen 1,999 dollarë?



iPhone 18 Pro pas një jave
përdorimi/ A ia vlen vërtet ta
ndërroni telefonin sipas Mateo
Kadriut...



Do të habiteni kur të zbuloni
fuqinë e kanellës!



A mund të konsumoni kafe gjatë
ushqyerjes në gjë?! Ja se çfarë
thotë studimi...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të
zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet
informativ dhe një larmi programesh kulturore.
27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana,
Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top
Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo
riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje
penale.

LINKS

Kontaktimi
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms